

VENDIM
Nr. 323, datë 22.7.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NR. 338, DATË 24.9.2020, “PËR CAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E STATUSIT TË NËPUNËSIT CIVIL GJYQËSOR, PUNONJËSVE NË DETYRË NË GJYKATA”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 113 dhe 117, të Kodit të Procedurave Administrative, nenet 61, 90, pika 1, shkronja “ç” dhe nenin 97, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në nenet 84–88, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 338, datë 24.9.2020, “Për caktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) në nenin 6, pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Për sekretarët gjyqësorë në detyrë, që kanë mbi 3 vjet përvojë pune në këtë pozicion dhe janë me arsim të lartë, kriteri i diplomimit në drejtësi nuk përbën shkak për të mos njohur statusin e nëpunësit gjyqësor civil, nëse Këshilli i Gjykatës vlerëson pozitivisht performancën e tij në punë.”.

2. Ngarkohen gjykatat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami